

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Supervizimi i vepres : “Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga rezervuari i Likomilit në rezervuarin e Vriserasë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71521000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.008.643 (Dy milion e tetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023 ,2024, 2025) lëshuar nga autoriteti përkatës, **ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se **40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në **nenin 55**, "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** pika 4: "Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. **Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkojnë, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: **Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës".**

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2023 , 2024 dhe 2025 **ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20 %** fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:

- Kur shërbimet janë realizuar me entet publike duhet të paraqitet kontrata e ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj shërbimi shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.
- Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posacme ,të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor ,operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”,e vlefshme,ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme,sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi ose Kontrata Bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri apo individ të licensuar për këtë kategori.

- | | |
|--------------|---|
| N.P-1 | (Punime germimi ne toke) |
| N.P-4 | (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale) |
| N.P-7 | “Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje” |
| N.S-1 | “Punime per prishjen e ndertimeve” |

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 41, pika 4/a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar dhe VKM nr 759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

Licensat e mësipërme kërkohej në bazë të zërave të preventivit të zbatimit të punimeve.

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

2.3.3.Një punësim mesatar i të paktën **5 (pesë)** personave,për periudhën të cilët duhet të figurojnë në list pagesat e shoqërisë **për tre muajt e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar si dhe list pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi.

(Kjo kërkesë do konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit ,këto dokumenta do paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari,përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4.Operatorët ekonomik pjesmarës duhet të kenë të punësuar staf inxhinjerik **si drejtues Teknik ,ose me kontratë** për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme ,librezë pune,diplomë te arsimit te larte ,Licensë individuale për mbikqyrje punimesh si më poshtë:

- Inxhinjer ndërtimi 1(Një)
- Inxhinjer hidroteknik 1 (Një)

2.3.5.Operatorët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar për:

a) Një punonjës i pajisur me certifikatë si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 dt.18/02/2010”për sigurinë dhe shëndetin në punë”dhe VKM nr.312 dt.05.05.2010 “për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantjer”shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,Diplomë/certifikatë,si dhe të figurojë në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.(në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik,secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një)punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”

b) Operatorët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre **1(një) specialist “Ekspert Zjarrfikës”** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.152/2015 “për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”,Neni 49,pika 4,shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,Diplomë/certifikatë ose **nëpërmjet kontraktimit.**

(Kjo kërkesë për pikat 2.3.4 dhe 2.3.5 do konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit ,këto dokumenta do paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari,përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinjerët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes se punimeve te zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinjerëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per periudhen 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Stafi inxhinjerik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinjerik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve, përkatësisht:

Inxhinier Ndërtimi - vleresim, verifikim dhe mbikqyrje te dokumentacionit tekniko-ligjor te projektit konstruktiv qe do te zbatohet si me poshte:

-Planin konstruktiv të përforcimit, prerjet, detaje konstruktive, llogaritjet dhe skema të vendosjes si dhe zbatimin në teresi të të gjitha projekteve të tjera për objektin.

Inxhinier hidroteknik - vlerësim, verifikim dhe mbikqyrje të dokumentacionit tekniko-ligjor të projektit është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të saktë të punimeve hidraulike, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

2.3.6 Operatoret ekonomik duhet të paraqesin certifikatat ISO si më poshtë:

a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga organizma Ndërkombëtarë Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001:2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga organizma Ndërkombëtarë Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për objektin e prokurimit janë hartuar në projekt-zbatimin e objektit **për objektin: “Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga rezervuari i Likomilit në rezervuarin e Vriserasë”** të përgatitur nga Inxhinjeret e Bashkise. Detajet e projektit të zbatimit janë publikuar

*në sistemin e app në procedurën me objekt: “**Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga rezervuari i Likomilit në rezervuarin e Vriserasë**”*

dhe preventivi i punimeve do të publikohet si pjesë përbërese e proçedurës në sistemin elektronik të APP-së.

Njesia e prokurimit.